



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE
EMERGIJENCËS

07-104/02- 1772 /26

Datë: 20.04.26



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Kaçanikut 01 Nr.60/01-12895/20, Rregulloren për përcaktimin e Procedurave të Dhenjes në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtëshme të komunës 01 Nr. 02-04/02-26493/20 si dhe Rregullores për taksat komunale 01Nr.02-8228/25 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, bën këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

**Për Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve publike në bulevardin
"Ismal Raka"- Kaçanik**

Përmes kësaj shpallje publike, njoftohen të gjithë operatorët ekonomik privat dhe ndërmarjet publike, se mund të aplikojnë për projektin "Menaxhimi dhe mirëmbajtja e parkingjeve publike në bulevardin "Ismajl Raka"-Kaçanik, për periudhën njëvjeçare.

Shpallja Publike bëhet për gjithësej 130 vendparkingje për automjete që janë nën 3.5 ton përgjatë bulevardit "Ismajl Raka"- Kaçanik.

Bazuar në Rregulloren për Taksa Komunale 01 Nr. 104/02-8228/25, çmimi fillestar për ofertim të një vendparkingu është 15€ (mujore).

1. KRITERET PËR OPERATORIN EKONOMIK

- Certifikatë e biznesit me shifrat të veprimtarisë.
- Numri fiskal (nëse nuk është në certifikatë të biznesit).
- Referenca për veprimtarinë e lartcekur (e preferueshme).

2. KAPACITETET TEKNIKE DHE FUQIA PUNËTORE

- Tetë (8) punëtorë të nevojshëm për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve,
- Një (1) automjet tërheqës-shërbimi merimangë- dëshmia e librezës së automjetit apo kontratë për shfrytëzim të automjetit të tillë).
- Hapësirë për parkim të automjeteve të konfiskuara - (dëshmoi e lokacionit apo marrëveshje për shfrytëzim të lokacionit adekuat për automjetet e konfiskuara).

Shpallja publike do të jetë 15 ditë, nga dita e publikimit.

Dokumentet e kompletuara dhe të mbyllura, dorëzohen në zyrën e pranimi më datën 04.02.2026 (e mërkure) në ora 14:00 (Hapja e zarfave bëhet nga komisioni komunal, në prani të ofertuesve ora 14:30).

Në mungesë të dokumenteve të kërkuara, aplikacioni do të refuzohet.

Për më shumë informacione dhe për marrjen e aplikacionit, mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.



Arian Teneqja

Drejtör i DSHPE-së